

RREGULLORE E BRENDSHME

Adoptuar nga Asambleja e Pergjithshme , Krete 30 Maj 2002

HYRJE

(1) Ndersa ne 1949 Grupi i Punes per Transportin Rrugor te Komitetit te Transportit Rrugor te Komisionit Ekonomik per Europen te Kombeve te Bashkuara dergoi te qeverite e Shteteve Anetare nje rekomandim duke i ftuar ata ti kerkojne siguruesve qe mbulojne riskun e pergjegjesise ndaj paleve te treta ne lidhje me perdorimin e automjeteve te lidhin marreveshje per krijimin e parashikimeve uniforme dhe praktike ne menyre qe te benin te mundur qe motoristet te jene te siguruar kur hyjne ne vende ku sigurimi ndaj nje risku te tille eshte i detyrueshem;

(2) Ndersa ky rekomandim konkludoi qe prezantimi i nje dokumenti uniforme sigurimi do te jete menyra me e mire per te arritur kete perfundim dhe vendosi principet baze te mareveshjes per tu konkluduar midis siguruesve ne vende te ndryshme;

(3) Ndersa Mareveshja Midis- Byrove, teksti i te ciles u miratua ne Nentor 1951 nga perfaqesuesit e siguruesve ne Shtetet te cilat, ne ate kohe, i ishin pergjigjur pozitivisht ketij rekomandimi, formoi bazat e maredhenieve midis siguruesve.

(4) Ndersa

a) qellimi i sistemit, normalisht i njohur si "Sistemi i Kartoinit Jeshil" ishte te lehtesonte qarkullimin nderkombetar te mjeteve motorike duke bere te mundur qe sigurimi i riskut per pergjegjesine ndaj paleve te treta ne lidhje me perdorimin e tyre, te plotesoje kriteret e vendosura nga vendi qe vizitohet dhe ne rast aksidenti, te garantoje kompensimin e paleve te demtuara ne perputhje me ligjin kombetar dhe rregullat e atij vendi;

b) Kartoni i sigurimit motorik nderkombetar ("Kartoni Jeshil"), i cili zyrtarisht njihet nga autoritetet e Shteteve qe kane adoptuar Rekomandimin e Kombeve te Bashkuara, eshte prove e sigurimit te detyrueshem te pergjegjesise civile ne lidhje me perdorimin e mjeteve motorike te pershkruara ketu, ne secilin vend qe vizitohet;

c) ne cdo Shtet pjesemarres nje Byro kombetare eshte krijuar dhe zyrtarisht eshte aprovuar ne menyre te siguroje nje garanci te dyfishte:

- qeverise se tij qe siguruesit e huaj do te pranojne ligjin e aplikuar ne ate vend dhe do te kompensojne palet e demtuara brenda limiteve te tij;
- Byrose se vendit visitor pergjegjesine e anetareve te saj te cilet mbulojne pergjegjesine ndaj paleve te treta ne lidhje me perdorimin e mjeteve motorike te perfshira ne aksident;

d) si rrjedhim i ketij mandati te dyfishte jo fitim prures, cdo Byroje i kerkohet te kete nje strukture te veten te pavarur finaciare te bazuar ne pergjegjesine e perbashket te siguruesve te autorizuar qe kryejne sigurimin motorik te detyrueshem per pergjegejsine civile ne lidhje me perdorimin e

mjeteve motorikete te cilet operojne ne tregun e tyre kombetar, e cila ben te mundur qe Byroja te plotesoje detyrimet qe lindin nga mareveshjet midis saj dhe byrove te tjera.

(5) Ndersa

a) disa Shtete, ne menyre qe te lehtesonin me teper trafikun nderkombetar rrugor, kane hequr dore nga kartoni jeshil ne kufijte e tyre nepermjet mareveshjeve te firmosura me Byrote e tyre respektive, kryesisht te bazuara ne regjistrimin e automjeteve;

b) sipas Direktives se tij te 24 Prill-it 1972 Keshilli i Byrove i propozoi Shteteve Anetare lidhjen e nje mareveshjeje te tille e njohur me vone si Mareveshja Suplementere Midis Byrove, e cila u firmos ne 16 Tetor 1972;

c) mareveshje te tjera, mbeshtetur ne te njeitin parim, bene te mundur qe Byrote e vendeve te tjera te behen anetare; dhe keto mareveshje u mblodhen ne nje dokument te vetem te firmosur ne 15 Mars 1991 dhe te quajtur Mareveshje shumepaleshe e Garancise.

(6) Ndersa tani eshte e deshirueshme te bashkohen te gjitha parashikimet qe rregullojne maredheniet midis Byrove ne nje dokument te vetem, Keshilli i Byrove, ne Asamblene e tij te Pergjithshme, mbajtur ne Rethymno(Crete) ne 30 Maj 2002 miratoi kete Rregullore te Brendshme.

PJESA I

RREGULLA TE PERGJITHSHME

(klauzola te detyrueshme)

Neni 1 – QELLIMI

Qellimi i kesaj Rregulloreje te Brendshme eshte te rregulloje maredheniet reciproke midis Byrove Kombetare te Sigurimit , duke zbatuar keshtu parashikimet e Rekomandimit nr.5 miratuar ne 25 Janar 1949 nga Grupi i Punes per Transportin Rrugor te Komitetit te Transportit Tokesor, te Komisionit Ekonomik European te Kombeve te Bashkuara, zevendesuar me Aneksin 2 te Resolutes se konsoliduar per lehtesimin e Transportit Rrugor (R.E.4) miratuar nga Grupi i Punes ne sesionin e tij 74 –tert mbajtur ne 25 deri ne 29 Qershor 1984, ne versionin e saj aktual, (ketu e me poshte e quajtur Rekomandimi Nr.5).

Neni 2 – PERCAKTIME

Per qellim te kesaj Rregulloreje te Brendshme fjalet dhe shprehjet e meposhtme do te kene kuptimin e dhene si me poshte dhe asnje tjeter;

2.1 "Byro Kombetare e Sigurimit" (ketu e me poshte e quajtur "Byro"): do te thote organizata profesionale e cila eshte anetare e Keshillit te Byrove dhe e institucionalizuar ne vendin e krijimit te saj, ne perputhje me Rekomandimin Nr.5.

2.2 "sigurues": do te thote cdo siper marrje e autorizuar te drejtoje biznesin e sigurimit te detyrueshem per pergjegjesine ndaj paleve te treta ne lidhje me mjetet motorike.

2.3 "anetar": do te thote cdo sigurues qe eshte anetar i nje Byroje.

2.4 "korespondent": do te thote cdo sigurues ose person tjetër i emeruar nga nje ose me shume sigurues me aprovimin e Byrose se vendit ku ky person eshte krijuar me qellimin e trajtimit te demeve te lindura nga aksidentet e ndodhura ne ate vend dhe nga pefshirja e automjeteve per te cilat siguruesi apo siguruesit ne fjale kane leshuar nje police sigurimi.

2.5 "automjet": do te thote cdo mjet motorik me qellim udhetimin ne toke dhe i vene ne levizje nga fuqi mekanike por jo qe leviz ne shina, si dhe cdo rimorkio me vete ose e lidhur me koken , por vetem ne ato raste ku mjete motorik ose rimorkio eshte objekt i sigurimit te detyrueshem motorik ne vendin ku ai eshte perdorur.

2.6 "aksident": do te thote cdo ngjarje qe shkakton humbje ose demtim shendetesor, te cilat ne perputhje me ligjin e vendit ku ka ndodhur, eshte brenda mbulimit te sigurimit te detyrueshem per pergjegjesine ndaj paleve te treta ne lidhje me perdorimin e mjeteve motorike.

2.7 "pale e demtuar": do te thote cdo person i cili ka te drejte te kerkoje kompensim ne lidhje me cdo humbje apo demtim shendetesor te shkaktur nga nje automjet.

2.8 "kerkese per demshperblim": do te thote nje ose disa kerkesa per kompensim te bera nga pala e demtuar dhe te lindura nga i njejti aksident.

2.9 "police sigurimi": do te thote nje kontrate e sigurimit te detyrueshem e leshuar nga nje anetar qe mbulon pergjegjesine civile ne lidhje me perdorimin e nje mjete motorik.

2.10 "i siguruar: do te thote cdo person, pergjegjesia e te cilit ndaj paleve te treta eshte e mbuluar me nje kontrate sigurimi.

2.11 "Karton Jeshil": do te thote Certifikata Nderkombetare e Sigurimit Motorik ne perputhje me modelin/modelet e aprovuar nga Keshilli i Byrove.

2.12 "Keshilli i Byrove": do te thote organizmi te i cili te gjitha Byrote duhet te jene anetare dhe i cili eshte pergjegjes per administrimin dhe operimin e sistemit nderkombetar te sigurimit te pergjegjesise civile motorike (i njohur si "Sistemi i Kartone Jeshil").

Neni 3 – TRAJTIMI I KERKESAVE PER DEMSHPERBLIM

3.1 Kur nje Byro eshte informuar per nje aksident te ndodhur ne territorin e vendit ne te cilin eshte kompetente, ne te cilin eshte pefshire nje mjet motorik i nje vendi tjetër, duhet te procedoje per

investigimin e rrethanave te aksidentit, pa pritur marrjen e nje kerkese per demshperblim formale. Duhet sa me shpejt te jete e mundur te njoftoje per aksidentin Siguruesin qe ka leshuar Kartonin Jeshil ose policen e Sigurimit, ose ne rast se eshte e nevojshme Byrone perkatese. Ne rast se Byroja nuk vepron si me siper, kjo nuk do te perdoret kunder saj.

Ne rast se gjate ketij investigimi Byroja shikon se Siguruesi i automjetit te pershire ne aksident eshte identifikuar dhe nje korespondent i ketij siguruesi eshte aprovuar konform parashikimeve te Nenit 4, duhet ti dergoje menjehere informacionin korespondentit per veprime te metejshme.

3.2 Me marrjen e nje kerkese per demshperblim te lindur nga nje aksident sipas rrethanave te pershkruara me lart, ne qofte se nje korespondent i siguruesit eshte aprovuar, Byroja duhet ta dergoje menjehere kerkesen per demshperblim te korespondenti, ne menyre qe te trajtohet dhe te demshperblehet ne perputhje me parashikimet e Nenit 4. Ne rast se nuk ka nje korespondent te aprovuar, ajo duhet te jape njoftim te menjehershem te siguruesi qe ka leshuar Kartonin Jeshil ose policen e sigurimit ose ne rast se eshte e nevojshme te Byroja perkatese e cila ka marre nje kerkese per demshperblim dhe do ta trajtoje ate, ose do te caktoj qe kerkesa per demshperblim te trajtohet nga nje agjent, identiteti i te cilit, gjithashtu duhet njoftuar.

3.3 Byroja eshte e autorizuar te trajtojte dhe te demshperbleje cdo kerkese per demshperblim ne menyre miqesore ose te pranoje sherbime te cdo procesi juridik qe perfshin pagesen e kompensimit.

3.4 Te gjitha kerkesat per demshperblim duhet te trajtohen nga Byroja me autonomi te plote, ne perputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatore te aplikueshme ne vendin e aksidentit te lidhura me pergjegjesine, kompensimin e paleve te demtuara dhe sigurimin e detyrueshem ne interesin me te mire te siguruesit i cili ka leshuar Kartonin Jeshil ose policen e sigurimit ose, ne rast se eshte e nevojshme, te Byrose perkatese.

Byroja do te jete ekskluzivisht kompetente per te gjitha ceshtjet qe i perkasin interpretimit te ligjit te aplikueshem ne vendin e aksidentit (edhe ne ato raste kur i referohet interpretimit te parashikimeve ligjore qe aplikohen ne nje vend tjetere) dhe trajtimin dhe demshperblimin e kerkeses per demshperblim. Ne varesi te ketij parashikimi te fundit, Byroja duhet, me kerkese te shprehur, te informoje Siguruesin, ose Byrone perkatese, para marrjes se nje vendimi final.

3.5 Kur demshperblimi i parashikuar tejkalon kushtet ose limitet e aplikueshme te percaktuara ne ligjin e sigurimit te detyrueshem motorik per pergjegjesine civile, ne fuqi, ne vendin e aksidentit, kur mbulohet nga nje police sigurimi, Byroja duhet te konsultohet me siguruesin ne lidhje me pjesen e demit qe tejkalon keto kushte ose limite. Miratimi i Siguruesit nuk kerkohet ne rast se ligji i aplikueshem detyron Byrone te marre ne konsiderate garancite kontraktuale ne tejkalim te ketyre limiteve apo kushteve te percaktuara ne ligj, lidhur me sigurimin ndaj pergjegjesise civile per perdorimin e mjeteve motorike ne vendin e aksidentit.

3.6 Nje Byro nuk mundet me vullnetin e vet ose pa pelqimin me shkrim te siguruesit ose Byrose perkatese, t'ja besojte kerkesen per demshperblim, ndonje agjenti i cili eshte financiarisht i interesuar ne te, sipas ndonje detyrimi kontraktual. Ne rast se vepron keshtu, pa nje miratim te tille, e drejta e tij per rimbursim do te kufizohet ne gjysmen e shumes perkatese te mbulueshme.

Neni 4 – KORESPONDENTET

4.1 Cdo Byro duhet te vendose kushtet sipas te cilave ajo jep, refuzon ose pushon aprovimin e saj per korespondentet e krijuar ne vendin per te cilin ajo eshte kompetente, perjashtur rastet kur eshte parashikuar ndryshe ne ndonje mareveshje te detyrueshme per Byrote e tjera dhe/ose ne ndonje dispozite ligjore apo rregullatore vendase.

Megjithate, aprovimi duhet te jepet automatikisht, kur kerkohet ne emer te nje anetari te nje Byroje tjeter, per cdo organizate te ketij anetari ne vendin e Byrose qe merr kerkesen, ne rast se nje organizate e tille eshte e autorizuar te ushtroje sigurimin motorik per pergjegjesine civile.

4.2 Byrote ne vendet anetare te Komitetit European marrin persiper te aprovojne si korespondent ne vendin e tyre, kur marrin nje kerkese te tille, perfaqesuesit e demeve qe jane emeruar nga siguruesit e Vendeve te tjera Anetare ne zbatim te Direktives 2000/26/EEC. Ky aprovim nuk mund te refuzohet, per sa kohe korespondenti ne fjale ruan kapacitetin e tij si perfaqesues i trajtimit te demeve, sipas Direktives te lartpermendur, vetem ne rast se ai ka thyrje te rende te detyrimeve te tij sipas ketij Neni.

4.3 Vetem nje Byro ka autoritetin, me kerkese nga njeri nga anetaret e saj, te dergoje te nje Byro tjeter nje kerkese per aprovim korespondenti i krijuar ne vendin e kesaj Byroje. Kjo kerkese duhet derguar me fax ose e-mail se bashku me proven qe korespondenti i propozuar pranon aprovimin e kerkuar.

Byroja perkatese duhet te jape ose refuzoje aprovimin e saj brenda tre muajve nga data e marrjes se kerkeses dhe duhet te njoftoje per vendimin e saj dhe daten e hyrjes ne fuqi, Byrone qe ka bere kerkesen si dhe korespondentin perkates. Ne rast se nuk eshte marre asnje pergjigje, aprovimi do te konsiderohet i dhene dhe me date te hyrjes ne fuqi, ditën e mbarimit te ketij afati.

4.4 Korespondenti duhet ti trajtoje te gjitha demet konform dispozitave ligjore apo rregullatore te aplikueshme ne vendin e aksidentit, te lidhura me pergjegjesine, kompensimin e paleve te demtuara dhe sigurimin e detyrueshem motorik, ne emer te Byrose qe ka aprovuar ate dhe per llogari te siguruesit qe ka kerkuar aprovimin e tij, per te gjitha aksidentet e shkaktuara ne ate vend, ku jane perfshire automjete te siguruara nga siguruesi qe ka kerkuar aprovimin e tij. Kur demshperblimi i parashikuar tejkalon kushtet ose limitet e aplikueshme te percaktuara ne ligjin e sigurimit te detyrueshem motorik per pergjegjesine civile, ne fuqi, ne vendin e aksidentit, kur mbulohet nga nje police sigurimi, korespondenti duhet te veproje ne perputhje me parashikimet e Nenit 3.5.

4.5 Byroja qe ka dhene aprovimin nje korespondenti e njeh ate si ekskluzivisht kompetent per trajtimin dhe pagesen e kerkesave per demshperblim ne emer te Byrose dhe per llogari te siguruesit qe ka kerkuar aprovimin e tij. Byroja duhet te njoftoje palet e demtuara per kete kompetence dhe duhet te dergoje te korespondenti cdo njoftim per te tilla kerkesa per demshperblim. Megjithate, ne cdo kohe dhe pa asnje lloj detyrimi per te justifikuar vendimin e saj, ajo mund ti marre trajtimin dhe demshperblimin e nje demi korespondentit.

4.6 N q.s, per cfaredolloj arsye, Byrose qe ka dhene aprovimin i kerkohet te kompesoje ndonje pale te demtuar, ne vend te korespondentit, ajo duhet te rimbursohet direkt nga Byroja nepermjet se ciles eshte derguar kerkesa per aprovim, ne perputhje me kushtet e vendosura ne Nenin 5.

4.7 Ne varesi te parashikimeve te Nenit 4.4, korespondenti eshte i lire te beje marreveshje per kushtet e rimbursimit te shumave te paguara paleve te treta dhe te metodave te llogaritjes se komisioneve te sherbimit te tij, me siguruesin qe ka kerkuar aprovimin e tij, mareveshje e cila, nuk do te jete e detyrueshme per tu zbatuar kundrejt ndonje Byroje.

N.q.s nje korespondent nuk ka mundur te marre rimbursimin e pagesave ne advance te bera ne perputhje me parashikimet e Nenit 4.4 per llogari te siguruesit qe ka kerkuar aprovimin e tij, ai duhet te rimbursohet nga Byroja qe ka aprovuar ate. Kjo e fundit rrjedhimisht do te rimbursohet nga Byroja ne te cilen siguruesi ne fjale eshte anetar ne perputhje me kushtet e vendosura ne Nenin 5.

4.8 Kur nje Byro eshte informuar qe nje nga anetaret e saj ka vendosur te heqe nje korespondent, duhet te informoje menjehere Byrone e cila ka dhene aprovimin. Kjo e fundit do te jete e lire te percaktoje daten ne te cilen aprovimi i saj do te pushoje se pasuri efekt.

Kur nje Byro qe ka dhene aprovimin per nje korespondent vendos te terheqe ate ose eshte informuar qe korespondenti deshiron qe aprovimi i tij te terhiqet, duhet te informoje menjehere Byrone qe ka sjelle kerkesen per aprovim te korespondentit. Gjithashtu duhet te njoftoje Byrone per daten efektive te terheqjes se korespondentit ose daten ne te cilen aprovimi i tij do te pushoje se pasuri efekt

Neni 5 – KUSHTET E RIMBURSIMIT

5.1 Kur nje Byro ose agjent i emeruar per kete qellim ka paguar te gjitha kerkesat per demshperblim te linduar nga i njeiti aksident duhet te dergoje, brenda nje periudhe mak simale prej nje viti nga data e pageses se fundit te bere ne favor te pales se demtuar, me fax ose e-mail te anetari i Byrose i cili ka leshuar Kartonin Jeshil ose policen e sigurimit ose, ne rast se eshte e nevojshme te Byroja perkatese nje kerkese per rimbursim qe specifikon:

5.1.1 shumat e paguara si kompensim pales se demtuar, si per perfundimin miqesor te pageses ashtu edhe ato te paguara me vendim gjykate;

5.1.2 shumat e disbursuara per sherbime te jashtme ne trajtimin dhe pagesen e cdo kerkese per demshperblim dhe te gjitha kostot e lindura specifikusht per arsye te veprimeve legale te cilat do te ishin disbursuar ne rrethana te ngjashme nga nje sigurues i krijuar ne vendin e aksidentit;

5.1.3 nje komision trajtimi qe mbulon te gjitha shpenzimet e tjera te llogaritura sipas rregullave te aprovuara nga Keshilli i Byrove.

Kur kerkesat per demshperblim te lindura nga i njeiti aksident jane mbrojtur dhe mbyllur pa u paguar ndonje kompensim, shuma te tilla ashtu si eshte parashikuar ne Nenin 5.1.2 me siper dhe komisioni minimum i percaktuar nga Keshilli i Byrove ne perputhje me nenin 5.1.3 me siper, mund te kerkohen.

5.2. Kerkesa per rimbursim duhet te specifikojte qe shumat per tu paguar, jane te pagueshme ne vendin dhe ne monedhen kombetare te perfituesit, te lira nga kostot, brenda nje periudhe prej dy

muajsh nga data e kerkeses dhe qe, ne perfundim te kesaj periudhe, interes vonese prej 12% ne vit per shumen per tu paguar nga data e kerkeses deri ne daten e marrjes se pageses nga banka e perfituesit do te aplikohet automatikisht.

Kerkesa per rimbursim gjithashtu duhet te specifikojë qe shumat e shprehura ne monedhen vendase jane te pagueshme ne Euro, me kursin zyrtar te kembimit ne daten e kerkeses, te vendit te Byrose kerkuese.

5.3 Ne asnje lloj rrethane kerkesat per rimbursim nuk duhet te perfshijne pagesa per gjoba, garanci per lirim me kusht ose gjoba te tjera financiare, te vendosura ndaj nje te siguruari te cilat nuk mbulohen nga sigurimi i pergjegjesise civile per perdorimin e mjeteve motorike ne vendin e aksidentit

5.4 Dokumenta justifikuese, perfshire kete proven objective qe kompensimi qe i detyrohen, i eshte paguar pales se trete, duhen derguar menjehere me kerkese por pa asnje vonese ne rimbursim.

5.5 Rimbursimi i te gjitha shumave te shprehura ne Nenin 5.1.1 dhe 5.1.2 me siper duhet te kerkohet ne perputhje me kushtet e vendosura ne kete Nen, pavaresisht nga fakti qe Byroja mund te mos kete paguar te gjitha kerkesat per demshperblim qe lindin nga i njeiti aksident. Komisioni i sherbimit sipas Nenit 5.1.3 me siper gjithashtu mund te kerkohet, kur shuma kryesore e cila eshte subjekt i rimbursimit tejkalon shumen e percaktuar nga Keshilli i Byrove.

5.6 N.q.s, mbas plotesimit te kerkeses per rimbursim, nje kerkese per demshperblim eshte rihapur ose nje kerkese tjeter per demshperblim e lindur nga i njeiti aksident eshte bere, bilanci i komisionit te sherbimit, nese ka, duhet llogaritur ne perputhje me dispozitat ne fuqi ne kohen kur kerkesa per rimbursim per kerkesen per demshperblim te rihapur apo te re, eshte bere.

5.7 Atje ku asnje kerkese per kompensimim muk ka resultuar, asnje komision sherbimi nuk mund te kerkohet.

Article 6 – DETYRIMI I GARANCISE

6.1 Cdo Byro duhet te garantoje rimbursimin nga anetaret e saj per cdo shume te kerkuar ne perputhje me parashikimet e Neni 5 nga Byroja e vendit te aksidentit ose nga ndonje agjent i emeruar per kete qellim.

N.q.s nje anetar deshton per kryerjen e pageses se kerkuar brenda nje periudhe prej dy muajsh te specifikuar ne Nenin 5, Byroja se ciles i perket ky anetar duhet te beje rimbursimin ne perputhje me kushtet e percaktuara ketu e me poshte, mbas marrjes se kerkeses per garanci te bere nga byroja e vendit ku ka ndodhur aksidenti, ose nga agjenti i emeruar per kete qellim.

Byroja qe qendron si garantuese duhet te beje pagesen brenda nje periudhe prej nje muaji. Ne mbarim te kesaj periudhe, nje interes vonese prej 12% ne vit per shumen per tu paguar, qe do te llogaritet duke filluar nga data e kerkeses per garanci deri ne daten e marrjes se pageses nga banka e perfituesit, do te aplikohet automatikisht.

Kerkesa e garancise duhet te behete me fax ose e-mail brenda nje periudhe prej 12 muajsh, pas dates se se dergimit te kerkeses per rimbursim sipas Nenit 5. Ne perfundim te kesaj periudhe dhe pa paragjykim per ndonje interes vonese per te cilin mund te jete pergjegjes, pergjegjesia e Byrose qe qendron si garantuese do te kufizohet ne shumen qe i kerkohet anetari te tij plus nje interes per 12 muaj i llogaritur ne 12 % ne vit.

Asnje kerkese per garanci nuk do te pranohet ne rast se ajo behet ne me teper se pas dy vjetesh, mbas dergimit te kerkeses per rimbursim.

6.2 Cdo Byro garanton qe anetaret e saj duhet te udhezojne korespondentet aprovimin e te cileve ata kane kerkuar, te trajtojne kerkesat per demshperblim ne perputhje me parashikimet e paragrafit te pare te Nenit 4.4 me siper dhe te dergoje te keta korespondente ose te Byroja e vendit te aksidentit te gjitha dokumentat qe i perkasin te gjitha demeve qe i jane besuar atyre.

Pjesa II

RREGULLA TE VECANTA QE RREGULLOJNE MAREDHENIET KONTRAKTUAKE MIDIS BYROVE TE MBESHTETURA NE KARTONIN JESHIL *(klauzola opsionale)*

Parashikimet e ketij seksioni aplikohen atje ku maredheniet kontraktuale midis byrove jane te mbeshtetura te Kartoni jeshil.

Neni 7 – LESHIMI DHE SHPERNDARJA E KARTONIT JESHIL

7.1 Cdo Byro eshte pergjegjese per printimin e Kartonave te saj Jeshil ose duhet te autorizojte Anetaret e saj per printimin e tyre.

7.2 Cdo Byro duhet te autorizojte anetaret e saj per te leshuar Kartona Jeshil siguruesve te tyre vetem per automjetet e regjistruara ne ate vend per te cilin ajo eshte kompetente.

7.3 Cdo anetar mund te autorizohet nga Byroja e tij per te leshuar kartona jeshil te siguruarve te tij ne cdo vend ku nuk ekziston asnje Byro, duke provuar qe anetari eshte i krijuar ne ate vend. Ky opsion eshte i limituar per automjetet e regjistruara ne vendin ne fjale.

7.4 Te gjitha Kartonat Jeshil do te konsiderohen te vlefshme te pakten 15 dite nga data e fillimit te tyre. Ne rast se ndonje Karton Jeshil eshte leshuar per nje periudhe me te vogel, Byroja e cila ka autorizuar leshimin e Kartonave Jeshil duhet ti garantoje mbulim Byrove te tjera ne vendet per te cilat kartoni eshte i vlefshem per nje periudhe 15 ditore qe nga data e fillimit te vlefshmerise se tij.

7.5 Kur nje mareveshje e firmosur midis dy Byrove sipas Nenit 16.3.5 anulohet, te gjitha Kartonat Jeshil te leshuar ne emer te tyre per perdorim ne territoret respektive do te shfuqizohen, ne momentin qe anulimi behet efektiv.

7.6 Kur nje marreveshje eshte anuluar ose pushuar sipas aplikimeve te Nenit 16.3.6, periudha e mbetur e vlefshmerise se Kartonit Jeshil leshuar ne emer te Byrove perkatese per perdorim ne territoret respektive do te percaktohet nga Keshilli i Byrove.

Neni 8 – KONFIRMIMI I VLEFSHMERISE SE KARTONIT JESHIL

Cdo kerkese per konfirmim per vlefshmerine e nje kartoni jeshil te identifikuar te derguar me fax ose e-mail te nje Byro nga Byroja e vendit te aksidentit ose nga ndonje agent i emeruar per kete qellim, i duhet dhene nje pergjigje definitive brenda nje periudhe tre mujore nga kerkesa. Ne rast se nuk jepet pergjigje ne mbarim te kesaj periudhe, Kartoni Jeshil do te konsiderihet i vlefshem.

Neni 9 – KARTONAT JESHIL FALLSO, TE PAAUTORIZUAR OSE TE NDRYSHUARA ILEGALISHT.

Cdo Karton Jeshil i paraqitur ne vendin per te cilin ai eshte i vlefshem , qe pretendohet te jete leshuar nen autoritetin e nje Byroje duhet te garantohet nga kjo Byro, edhe ne rast se ai eshte fallso, i paautorizuar ose ilegalisht i ndryshuar.

Megjithate garancia e Byrose nuk do te aplikohet kur Kartoni Jeshil nuk eshte i regjistruar ligjerisht ne vendin e kesaj Byroje, me perjashtim te rrethanave te specifikuara ne Nenin 7.3.

Pjesa III

RREGULLA TE VECANTA QE RREGULLOJNE MAREDHENIET KONTRAKTUALE MIDIS BYROVE TE MBESHTETURA NE MBULIMIN NE SIGURIM TE DHENE

(klauzola opsionale)

Parashikimet e ketij seksioni aplikohen kur maredheniet midis Byrove jane mbeshtetur ne mbulimin ne sigurim te dhene, me disa perjashtime.

Neni 10 – DETYRIMET E BYROVE

Byrote per te cilat keto parashikime aplikohen duhet te garantojne, ne baza plotesisht reciproke, rimbursimin e te gjitha shumave te pagueshme sipas ketyre Rregullave te lindura nga cdo aksident ku perfshihen automjete te cila jane normalisht te vendosura ne territorin e Shteteve per te cilin secila nga keto Byro eshte kompetenete, pavaresisht nese automjeti eshte i siguruar ose jo.

Neni 11 – KONCEPT I BAZUAR NORMALISHT

11.1 Territori i Shtetit ne te cilin automjeti eshte i bazuar normalisht eshte percaktuar mbeshtetur ne ndonje nga kriteret e meposhtme:

11.1.1 territori i Shtetit, nje targe te te cilit mban automjeti;

11.1.2 atje ku nuk kerkohet regjistrim per nje tipi automjetiti, por automjeti mban nje targe sigurimi, ose nje shenje dalluese analoge me nje trage regjistrimi, territori i shtetit ne te cilin targa e sigurimit apo shenja eshte leshuar;

11.1.3 atje ku si targe regjistrimi apo edhe targe sigurimi ashte si edhe shenja dalluese nuk kerkohet per tipe te caktuara automjetesh, territori i shtetit ne te cilin personi qe ka ne ruajtje automjetin, eshte resident i perhereshem;

11.2 N.q.s nje automjet qe kerkohet te mbaje nje targe regjistrimi nuk ka targe/targa, ose nuk ka targa te leshuara legalisht, eshte perfshire ne nje aksident, territori i vendit ku ka ndodhur aksidenti, do te konsiderohet si territori ku automjeti eshte i bazuar normalisht, per trajtimin e ndonje kerkese per demshperblim te resultuar.

Neni 12 – PERJASHTIME

Parashikimet e ketij seksioni nuk aplikohen te:

12.1 automjetet e regjistruara ne vendet e tjera nga vendet e Byrove per te cilat aplikohen parashikimet e ketij seksioni dhe per te cilat nje karton Jeshil eshte leshuar nga nje anetar i ketyre Byrove. Ne rast te nje aksidenti ku eshte perfshire nje automjetet per te cilin eshte leshuar nje Karton Jeshil Byroja perkatese do te veproje ne perputhje me rregullat e vendosura ne Seksionin II.

12.2 automjetet qe i perkasin personave te caktuar, ne rast se Shteti ne te cilin ata jane regjistruar ka krijuar ne Shtete te tjera nje autoritet apo person pergjegjes per kompensimin e paleve te demtuara ne perputhje me kushtet qe ekzistojne ne vendin e aksidentit.

12.3 tipe te caktuara automjetesh qe mbajne nje targe te vecante, perdorimi i te cilave ne trafikun nderkombetar eshte bere kushtezues nga ligji i vendit i cili vizitohet nga ato, te cilet jane te paisur me Karton Jeshil ose Police Sigurimi Kufitare.

Lista e automjeteve referuar sipas Nenit 12.2 dhe 12.3 si dhe lista e autoriteteve ose personave te emeruar ne vendet e tjera, duhet te pergatitet me shkrim nga secili vend dhe i duhet komunikuar Keshillit te Byrove nga Byroja e atij Shteti.

Neni 13 –KONFIRMIMI I TERRITORIT NE TE CILIN NJE AUTOMJET ESHTË I BAZUAR NORMALISHT

Cdo kerkese per konfirmimin e territorit ne te cilin nje automjet eshte i bazuar normalisht derguar me fax ose e-mail te nje Byro nga Byroja e vendit te aksidentit ose nga nje agjent i emeruar per kete qellim duhet ti jepet nje pergjigje definitive brenda tre muajve nga kerkesa. Ne rast se nje pergjigje e tille nuk eshte marre, atehere ne perfundim te kesaj periudhe do te konsiderohet te jete konfirmim qe automjeti eshte i bazuar normalisht ne territorin e asaj Byroje.

Neni 14 – KOHA E GARANCISE

Byrote mund ta kufizojne kohën e garancisë që ato japin sipas Nenit 10 në lidhje me:

14.1 automjetet me targa regjistrimi të perkoheshme, formati i të cilave është njoftuar me parë Këshillit të Byrove. Në rastet e tilla koha e garancisë do të jetë për 12 muaj mbas datës së përfundimit të periudhës së vlefshmërisë të pasqyruar në targë;

14.2 çdo automjet tjetër që është subjekt i kushteve të marrëveshjeve reciproke të firmosura me Byrote e tjera dhe të komokuara Këshillit të Byrove.

Neni 15 – APLIKIMI NJEPALSH I GARANCISE MBESHTETUR NË MBULIMIN NË SIGURIM TË DHENË.

Duke ruajtur parashikimet ligjore kundërshtuese, Byrote mund të bien dakort për aplikim njëpalësh të këtij Seksioni brenda kontekstit të marrëdhënieve bilaterale.

Pjesa IV

RREGULLAT QË RREGULLOJNË MARRËVESHJET MIDIS BYROVE KOMBËTARE TË SIGURUESVE.

(dispozita të detyrueshme)

Neni 16 – MARRËVESHJET DYPALËSHE- KUSHTET

16.1 Byrote mund të bëjnë marrëveshje dypalëshe midis tyre sipas të cilave ato marrin përsiper brenda kontekstit të marrëdhënieve reciproke të tyre, të pranojnë dispozitat e detyrueshme të Rregullores së Brendshme si dhe dispozitave opsionale të specifikuara këtu e më poshtë.

16.2 marrëveshje të tilla duhet të firmosen në tre kopje nga Byrote kontraktuese, të cilat duhet të mbanjë një kopje. Kopja e tretë duhet dërguar Këshillit të Byrove i cili, mbas konsultimit me palet përkatëse, i njofton ato për datën e fillimit të marrëveshjes së tyre.

16.3 Të tilla marrëveshje duhet të përfshijnë klauzola të cilat sigurojnë;

16.3.1 identifikimin e Byrove kontraktuese duke përmendur statusin e tyre si Anëtarë të Këshillit të Byrove dhe territoret për të cilat ato janë kompetente.

16.3.2 detyrimi i tyre që pranojnë dispozitat e detyrueshme të kësaj Rregulloreje të Brendshme.

16.3.3 detyrimi i tyre që pranojnë dispozitat e klauzoles opsionale, ashtu si është zgjedhur dhe rënë dakort.

16.3.4 autoritet reciproke te aprovuara nga keto Byro, ne emer te tyre dhe per llogari te anetareve te tyre, per te trajtuar kerkesa per demshperblim miqesisht ose duke pranuar sherbime te ndonje procesi jashte gjyqesor ose gjyqesor, per te paguar kompensim qe rezulton nga ndonje aksident brenda fushes dhe qellimit te kesaj Rregulloreje te Brendshme.

16.3.5 kohe te palimituar te mareveshjes, duke ruajtur te drejten e cdo Byroje kontraktuese te perfundojne ate, me 12 muaj njoftim, duke njoftuar njekohesisht palen tjetere dhe Keshillin e Byrove.

16.3.6 anulimin ose pushimin automatikisht te mareveshjes ne rast se Byroja kontraktues pushon se qeni Anetar i Keshillit te Byrove ose anetaresia e tij eshte pushuar.

16.4 Nje model te kesaj mareveshjeje bashkangjitur. (Aneksi III).

Neni 17- PERJASHTIME

17.1 me perjashtimet te Nenit 16, Byrote e shteteve Anetare te Komuniteti European duhet, ne perputhje me Nenin 2 te Direktives Europiane te 24 prill-it 1972 (72/166/EEC) te bejne te njohur, pranimin reciprok te kesaj Rregulloreje te Brendshme nepermjet nje mareveshjeje shumepaleshe data e fillimit te se ciles do te percaktohet Komisioni i Komitetit European ne bashkepunim me Keshillin e Byrove.

17.2 Byrote ne Shtetet jo-anetare te Komunitetit European mund te hyjne ne kete mareveshje shumepaleshe duke respektuar kushtet e vendosura nga komiteti kompetent ashtu si eshte e percaktuar ne Statutin e Keshillit te Byrove.

Pjesa V

PROCEDURA PER NDRYSHIMENE RREGULLORES SE BRENDSHME

(dispozita te detyrueshme)

Neni 18 – PROCEDURA

18.1 Cdo ndryshim ne kete Rregullore do te jete kompetence ekskluzive e Asamblese se Pergjithshme te Keshillit te Byrove.

18.2 Me perjashtim te sa me siper:

- a) cdo ndryshim ne parashikimet e vendosura ne Seksionin III do te jete kompetence ekskluzive e komitetit ashtu si eshte e percaktuar ne Statutin e Keshillit te Byrove. Keto parashikime jane te detyrueshme per Byrote te cilat, pavaresisht se nuk jane anetare te ketij komiteti, kane zgjedhur te aplikojne Seksionin III ne maredheniet e tyre kontraktuale me Byrote e tjera dhe .
- b) cdo ndryshim ne Nenin 4.2 do te jete kompetence ekskluzive e Byrove te Komunitetit European.

Pjesa VI

ARBITRAZHI

(dispozita te detyrueshme)

Neni 19 – KLAUZOLA E ARBITRAZHIT

Cdo mosmareveshje qe lind nga kjo Rregullore e Brendshme ose te lidhura me to do te zgjidhet nga arbitrazhi ne perputhje me rregullat e arbitrazhit te UNCITRAL (Komisioni i Kombeve te Bashkuara ne Ligjin Nderkombetar te Tregut) ne ate kohe ne fuqi.

Keshilli I Byrove do te vendose per komisionet e arbitrave dhe kostove te aplikueshme.

Pergjegjesia per emerimin e Arbitruesve do te jete e Presidentit te Keshillit te Byrove ose , ne rast se eshte e pamundur, do te jete e Kryetarit te Nomination Committee.

Trupi gjykuesi i Arbitruesve duhet te perbehet nge tre arbitrues.

Procedurat e arbitrimit duhet te behen ne Anglisht dhe Frengjisht.

Pjesa VII

HYRJA NE FUQI

(dispozita te detyrueshme)

Neni 20 – HYRJA NE FUQI

Kjo Rregullore do te hyje ne fuqi ne 1 Korrik 2003.

Qe nga kjo dite ajo do te zevendesojne Mareveshjen Uniforme dhe Mareveshjen Shumepaleshe te Garancise te firmosura midis Byrove.

Anekse

Aneksi I: Rekomandimi n°5

Aneksi II: Direktiva e 24 Prill 1972 (72/166/EEC)

Aneksi III: Nje Model i mareveshjes midis Byrove

Byroja.....

Anetare e Keshillit te Byrove

dhe

Byroja

Anetare e Keshillit te Byrove

Ketu e me poshte marrin persiper te pranojne dispozitat e detyrueshme te Rregullores se Brendshme te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Keshillit te Byrove ne 30 Maj 2002 si dhe te pranojne dispozitat opsionale te Seksionit.....

Keto detyrime do te aplikohen gjithashtu te cdo ndryshim i mevonshem i Rregulloresste Brendshme ne fjale.

Ketu e me poshte jep autoritet reciprok te pranoje sherbime te cdo procesi gjyqesor ose jasht gjyqesor per pagesen ose trajtimin ne menyre miqesore te kerkesave per demshperblim te lindura nga nje aksident brenda konteksit te Rregullores se Brendshme.

Kjo mareveshje lidhet per nje periudhe te pakufizuar. Megjithate, secili nga palet mund ta perfundoje ate me 12 muaj njoftim. Njoftimi i perfundimit duhet ti jepet njekohesisht pales tjeter ne mareveshje dhe Sekretarit te Pergjithshem te Keshillit te Byrove.

Gjithashtu bihet dakort se kjo mareveshje do te perfundoje ose pushoje automatikisht n.q.s njeri nga te dy palet pushon se qeni nje Anetar i Keshillit te Byrove ose i eshte pushuar anetaresia.

Data e Hyrjes ne fuqi te kesaj mareveshjeje do te komunikohet te palet nga Sekretari i Pergjithshem i Keshillit te Byrove mbas marrjes se nje kopjeje te firmosur nga te dyja palet.